



THIRRJE PËR OFERTIM

CALL FOR OFFER

Titulli i projektit / Project Title:	Let's PLAY Maths
Titulli i aktivitetit / Activity Title:	Blerje e paisjeve per qellim te implementimit te projektit: Training of future teachers by university professors
Numri i referencës së projektit / Project Reference Number	Reference number: 2024-1-FR01-KA220-SCH-000252562
Agjencia donatore / Sponsoring Agency:	Erasmus +
Periudha e implementimit të projektit/ Project Implementation Period:	24 muaj

1. Informata rreth Kolegjit AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë i cili është themeluar menjëherë pas luftës në Kosovë, pas krijimit të rrethanave të reja ekonomike-sociale e kulturore, kur u krijuan kushte dhe rrethana për jetë normale të qytetarëve të Kosovës. Në fillimet e tij institucioni ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv duke u zgjeruar vazhdimisht me programe studimore në fushat e tjera dhe duke u shndërruar kështu në institucion model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Sot, Kolegji AAB ofron programe studimi të nivelin bachelor dhe master në 14 fakultete të ndryshme. Njëkohësisht, Kolegji AAB është implementues i shumë projekteve ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

2. Informata të përgjithshme rreth projektit

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të projektit "Let's PLAY Maths" i cili ka për qëllim të te përgatis stafin edukativ që të përdor lojërat për të ju mësuar nxënësve operacionet matematikore përmes lojërave. Kolegji AAB është partner në këtë projekt. Projekti parasheh aktivitete që lidhen me aktivitetin fizik dhe matematikën. Janë zhvilluar gjithsej 4 lojëra. Në trajnimin e parë i cili është mbajtur në Shkup në muajin korrik 2025, 4 profesorë të AAB janë trajnuar nga stafi i Play International. Faza e ardhshme është planifikuar që 4 profesorët e AAB t'i trajnojnë edhe 4 profesorë të tjerë. Ky trajnim do të mbahet gjatë javë se ardhshme në Kolegjin AAB. Projekti financohet nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.



3. Objekti i ofertës

Të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë që të dorëzojnë ofertat e tyre për blerjen e pajisjeve të listuara në vijim:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve/	Specifikat teknike të pajisjeve	Sasia
1	Çantë sportive	Logo	30
2	Fanella	4 ngjyra të ndryshme (450 të portokalltë, 450 të verdhë, 450 të kuqe, 450 të kaltër)	1800
3	Kona të vegjël	4 ngjyra të ndryshme (600 të portokalltë, 600 të verdhë, 600 të kuqe, 600 të kaltër)	2400
4	Kona të vegjël	600 copa ngjyrë të bardhë	600
5	Kona te bute per hedhje (ose bean bags)	/	1500
6	Hula Hoops (rrathë)	(150 e kuqe ; 150 kalter ; 150 verdhe; 150 portokalli)	600
7	Ping Pong Balls	/	6000
8	Shirita të gjatë (për shënjim)	/	3000
9	Kuti të vogla të plastikës	Kuti të thella për të vendosur 3–10 topa ping pong.	120
10	Kuti të vezëve	Kuti vezësh me hapësirë vetëm për 10 vezë.	600
11	Zare	Të personalizuar	120
12	Numërues rezultatesh		120
13	Bilbil	/	30
14	Kronometër	/	30
15	Çantë e ndihmës së parë		30



4. Kushtet dhe kriteret për aplikim

Të gjitha bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ofertën financiare (bazuar në specifikat, çmimin e ofruar për njësi dhe kohën e liferimit).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Certifikatën e TVSH-së

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në formë elektronike në email-in dardan.krekaj@universitetiaab.com dhe projects@universitetiaab.com me subject "Ofertë për "Let's PLAY Maths". Çdo formë tjetër e dorëzimit të ofertave do të konsiderohet e papranueshme.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më datën: 31.10.2025 në ora 16.00.

Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në bazë të kriterëve si në vazhdim: çmimit ekonomikisht më të favorshëm (40 pikë), përmbushjes së specifikave teknike (40 pikë), dhe kohës së liferimit (20 pikë).

